



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 26.10.2023

Nr: 186

Ora: 13:00

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 32, DATË 19.10.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.10.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Tonin Marinaj, kryetar dhe njëkohësisht kandidat për kryetar për bashkinë Malësi e Madhe dhe ndaj z. Kastriot Dragaj, Drejtor i shkollës 9-vjeçare “Fran Murriz”, në Pjetroshan, Malësi e Madhe.

BAZË LIGJORE:

Neni 19, pika 1, shkronja "c" dhe neni 21, pika 1, shkronja "dh" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë denoncime për shkelje administrative nga ana e kryetarit dhe kandidatit për kryetar për bashkinë Malësi e Madhe si dhe nga ana e drejtorit të shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroshan, Malësi e Madhe, për të cilin pretendohet se ka patur shkelje administrative të parashikimeve ligjore.
2. Denoncimi regjistruar me nr. 413 ID i ardhur shkresërisht i administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. 4859 prot., datë 9.5.2023, ndaj Z. Tonin Marinaj, Kandidat dhe Kryetar i bashkisë Malësi e Madhe, si dhe z. Kastriot Dragaj, Drejtor i shkollës 9 vjeçare " Fran Murrizi", Malësi e Madhe, për 1 (një) veprimtari publike. Në rastin e denoncimit nr. 413 ID, në kundërshtim me nenin 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor, drejtori i shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroshan, Malësi e Madhe, z. Kastriot Dragaj ka vënë në dispozicion të kandidatit për kryetar bashkie, ambientet e shkollës për qëllime të fushates elektorale brenda periudhës së fushatës zgjedhore.
3. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ, në përfundim të të cilit ka arritur në konkluzionin se kryetari i bashkisë njëkohësisht dhe kandidat për kryetar të bashkinë Malësi e Madhe, me zhvillimin e këtij aktiviteti elektoral në ambientet e shkollës 9- vjeçare "Fran Murrizi" Pjetroshan, Malësi e Madhe, konstatohet se ka përdorur burime publike në mbështetje të fushatës së tij zgjedhore. Kryetari në detyrë i bashkisë nuk mund të përdor institucione publike në interes të fushatës elektorale dhe as në mbështetje të fushatës së tij. Përdorimi i këtyre aseteve nga ana e kryetarit përbën qartësisht veprimtari të ndaluar sipas vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

4. Me anë të vendimit nr. 796, datë 06.10.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur t'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, gjobë në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë për z. Tonin Marinaj, kryetar dhe njëkohësisht kandidat për kryetar për bashkinë Malësi e Madhe dhe gjobë në vlerën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë për z. Kastriot Dragaj drejtori i shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroschan, Malësi e Madhe.
5. Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë e regjistruar me nr. 32, datë 19.10.2023, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë duke e mbështetur këtë propozim në nenin 171 pika 1 dhe 2 e Kodit Zgjedhor.
6. KQZ caktoi me short anëtarin e KAS-it z. Koli Bele relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 32, datë 19.10.2023 të Komisionerit. KAS në seancën paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më datë 26.10.2023, ora 13:00.
7. Seanca e datës 26.10.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, specialistëve të administratës së KQZ-së si dhe palë në procesin e shqyrtimit administrativ Qendra "Qëndresa Qytetare". Palët janë njoftuar rregullisht konform ligjit.
8. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi këto prova shkesore:
 - Kërkesën nr. 32, datë 19.10.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - Vendimin nr. 796, datë 06.10.2023, "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit regjistruar me nr. 413 ID, të Qendrës "Qëndresa Qytetare", ndaj z. Tonin Marinaj kryetar dhe kandidat për kryetar bashkie për bashkinë Malësi e Madhe si dhe ndaj z. Kastriot Dragaj drejtori i shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", në Pjetroschan, Malësi e Madhe për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023";
 - Denoncimin nr. 413 ID, datë 9.5.2023 si dhe foto/prova bashkëlidhur;
 - Njoftimet/komunikimi nëpërmjet postës elektronike për zhvillimin e senacave dhe kërkesa për informacion me personat objekt hetimi;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton se:

1. Veprimtaria e denoncuar me anë të denoncimit **nr. 413 ID**, është veprimtari publike e zhvilluar në kuadër të fushatës zgjedhore të kandidatit për kryetar bashkie në bashkinë Malësi e Madhe, z. Tonin Marinaj, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 Maj 2023. Për këtë rast konstatohet se kemi të bëjmë me takim elektoral me banorët e fshatit të zhvilluar në mjediset e jashtme, brenda murit rrethues të shkollës 9-vjeçare “Fran Murrizi”, në Pjetroshan. Kjo veprimtari është zhvilluar në datën 03.05.2023, brenda periudhës së fushatës zgjedhore.
2. Hetimi administrativ i Komisionerit ka provuar “se kryetari i bashkisë Malësi e Madhe, njëkohësisht kandidat për kryetar në bashkinë Malësi e Madhe, me zhvillimin e fushatës elektorale në ambientet e jashtme të shkollës 9-vjeçare “Fran Murrizi”, ka përdorur burime publike në mbështetje të fushatës së tij zgjedhore”.
3. Sipas deklarimeve në seancë të përfaqësuesve të administratës së KQZ-së dhe dokumentacionit të administruar, nuk provohet se drejtori i shkollës 9-vjeçare “Fran Murrizi”, në Pjetroshan, Malësi e Madhe nuk ka pasur dijeni për zhvillimin e kësaj veprimtarive elektorale. Gjithashtu nuk u provua as nga materialet e dosjes hetimore se drejtori i shkollës të këtë vënë në dispozicion ambiente të brendshme të shkollës për zhvillimin e takimit electoral.
4. Sikurse ka konstatuar edhe vetë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, z. Tonin Marinaj ka marrë pjesë në këtë veprimtari në cilësinë e tij si kandidat për kryetar bashkie për bashkinë Malësi e Madhe. Kodi Zgjedhor, në pikën 20 të nenit 2 përcakton se **“subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod**”. Kjo do të thotë, se në trajtimin e shkeljes së konstatuar, Komisioneri do duhej ta trajtonte

kandidatin në cilësinë e tij si subjekt zgjedhor dhe jo si kryetar bashkie në detyrë. KAS-i për rastet e ngjashme të kësaj natyre ka mbajtur të njëjtin qëndrim nepërmjet vendimmarrjes së tij nr. 84, datë 08.05.2023; vendimi nr. 85, datë 08.05.2023; vendimi nr. 87, datë 10.05.2023 si dhe në vendimin nr. 115, datë 18.05.2023 (shih vendimet). Ky qëndrim është konfirmuar nga Kolegji Zgjedhor me vendimmarrjen e tij nr. 22, datë 24.05.2023 (shih vendimin).

5. Komisioneri ka bërë referimin e gabuar ligjor, kur ka kërkuar që ndaj kandidatit për kryetar bashkie, z. Tonin Marinaj të merret masë administrative m e gjobë *“referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ku parashikohet se “shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën veprë penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë.*
6. Pika 1, e nenit 172 të Kodit Zgjedhor përcakton se *“subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijëni, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes”*. Kandidati për kryetar bashkie, z. Tonin Marinaj ka qenë oreganizator ose ne cdo rast në dijëni të zhvillimit të veprimtarisë në ambientet e jashtme brenda murit rrethues të shkollës. Kjo veprimtari organizohej nga strukturat e tij të fushatës dhe si e tillë është postuar në faqen e tij në Facebook më datë 03.05.2023. Në këto rrethana ai ka pasur detyrimin për ndërprerjen e menjëhershme të shkeljes, gjë që nuk ka ndodhur. Në kushtet kur ai ka qenë në cilësinë e subjektit zgjedhor si kandidat për kryetar bashkie i Bashkisë Malësi e Madhe në këtë aktivitet, është e qartë se aktiviteti në shkelje të ndalimeve në K.Zgjedhor. Veprimtaria është kryer në favor të fushatës së tij zgjedhore.
7. Në lidhje me të drejtën e ankimit, sa i përket z. Tonin Marinaj, duke qenë se ai është dënuar administrativisht në cilësinë e subjektit zgjedhor, në zbatim të nenit 145, pika 1 të K.Zgjedhor që parashikon se *“Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi”*, ai mund ta ushtrojë të drejtën e ankimit duke ju drejtuar Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, sipas përcaktimeve ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja 'dh', si dhe në nenin 172, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës nr. 32, datë 19.10.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Tonin Marinaj, kryetar dhe kandidat për kryetar për bashkinë Malësi e Madhe, sipas nenit 172, pika 1 të Kodit Zgjedhor, gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë.
3. Rrëzimin e kërkesës për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Kastriot Dragaj, Drejtori i shkollës 9-vjeçare "Fran Murrizi", Pjetërshan, Malësi e Madhe.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit brenda 30 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

U shpall sot, më datë 26.10.2023.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar